



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-060/01-23257

Pejë, datë: 17 prill 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i –III- i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **17 prill 2025** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina; përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 29 anëtarë prezent.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 28 vota pro, 1 votë e përmbajtur, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbaleve të Kuvendit të Komunës së Pejës (dt. 31.01.2025 dhe dt. 28.02.2025).
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Leutrim (Florim) Kelmendi me ¼ dhe Ramë (Bajram) Muzlija me ¾, për qëllim të Interesit Publik: “Krijimi i Hapësirës për Varreza në fshatin Ramun”.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat me shtëpi në pronësi të Anxha (Radosav) Ivanoviq dhe Radosav (Bogdan) Ivanoviq, me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini dhe me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini, për qëllim të Interesit Publik: Rregullimin e sipërfaqes publike buzë Lumit Lumbardh dhe shtratin e Lumit Lumbardh.

6.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Kimete (Adem) Hasaj (bancësë), për qëllim të Interesit Publik: “Ndërtimi i Qendrës Kryesore Familjare”.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat Shkelzen (Ismajl) Gutiqi; Qehaja Group SH.P.K; Raif (Hivzi) Kelmendi me 6/7 dhe Ali (Hivzi) Kelmendi me 1/7, për qëllim të Interesit Publik: “Rregullimi i Shtratit të Lumbardhit”.

8.Shqyrtimi dhe miratimi për shfuqizimin e Vendimit Nr. 03/2025 me nr. protokolli 463/01-10508, dt. 28 Shkurt 2025 K.K. Pejë, mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negociim nga Kryetari i Komunës - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-128/3 të dt. 24.03.2025.

9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negociim nga Kryetari i Komunës.

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi për propozim - shfuqizimin e Vendimit Nr. 76/20254 me nr. protokolli 463/01-98164, dt. 30 Dhjetor 2024, mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025.

11.Rishqyrtimi dhe miratimi paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025.

12.Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.01-2025 (KPE) për Shërbimin e Transportit me Merimangë në territorin e Komunës së Pejës, të dt. 31.01.2025, në kërkesës së MMPHI-së nr. Nr. 04-1944, dt: 25.02.2025.

13Shqyrtimi dhe miratimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Planin të Zyrës për Komunitete për 2025.

14.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

15.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan z.Rrustem Berisha, z.Granit Kelmendi, dhe z.Islam Husaj, znj.Fjolla Dembogaj.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbaleve të Kuvendit të Komunës së Pejës (dt. 31.01.2025 dhe dt. 28.02.2025).

Nga të gjithë anëtarët prezent me 28 vota pro, 1 votë e përmbajtur, miratohen procesverbalet nga seancat e kaluara.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Leutrim (Florim) Kelmendi me ¼ dhe Ramë (Bajram) Muzlijaj me ¾, për qëllim të Interesit Publik: “Krijimi i Hapësirës për Varreza në fshatin Ramun”.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: me këtë ndrim po mbrijmë me i siguru varrezat në Ramun, për një kohë të gjatë. Po ashtu si ekzekutiv ose si asamble komunale na mbetet me bë zgjidhje vetem edhe për fshatin Pavlan, sepse nuk kemi mundu me ju bo zgjedhje deri me sot!

z.Naim Bytyqi: pyetja ime për këtë rast është direkt për kryetarin, këmbimet që janë bë kohen e fundit a ka kalu ligjëshmeria e tyre? Sepse një interpretim i ri ligjor që ka ndodhë në MAPL-në, rasti kur vlera e pronës komunale është me e madhe se sa pronës private në këtë rast do të thotë nuk është duke i kalu ligjëshmeria kësaj prone! Më intereson se a është e vërtetë kjo apo nuk është e vërtetë? Po ashtu edhe një çështje tjetër unë kesh i vizitova ato toka afer shtëpise së familjes Ahmeti dhe po mendoj që kjo puna e varrezave është duke u përdorur shumë gjoja se për të mire e banoreve. Si ka mundësi që një banor i fsh.Zahaq dhe një banor i fsh.Leshan me ble tokë në fsh.Ramun, kush po i kurdis këto blerje? Kush po i thot atij shko bleje e bëjm pronë komunale e pastaj e ndrojmë për varreza? Unë, kam bisedu me banoret e fshatit dhe ata janë të interesuar që varrezat me i hek prej dritareve të shtëpise, dhe nuk është se i gjithë fshati është pro kësaj pune! Nuk po du me dal kunder varrezave vetem të jem i qartë, por mua po me intereson kurdisja se kush po i bën, kush është ai ekspert që po i bën keto kurdisje?

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: unë, vetem muj me tu përgjigjë në pyetjet që janë të qarta. Secili veprim që e kemi dërgu në MAPL është i ligjshëm qeto u përgjigja! Ndërsa për keto punë hipotetike fsh.Ramun ka kërku zgjerimin e varrezave dhe me kerkesen e tyre është bë zgjerimi. Për këtë punë na mundohemi që 4-5 vite me negociu me pronarin e asej toke i cili jeton në Prishtinë. Ndërsa sa i perket blerjeve unë si kryetar i komunës i kam 150 njerëz që kërkojnë me bo qare dhe me bo ndrime. Na j'u shpejgojmë se ku munden me bo atë ndrim, për me siguru se qka është interes publik dhe qka është interes privat. Intersin publik e përfaqësoj une dhe ju tregoj që për komunën e Pejës interes është kjo për me u zgjeru banesa, ndërsa pronaret privat gjejnë mënyra me i bo keto shitblerje dhe me siguru këtë ndrim kjo është ana ligjore. Ligji në të

kaluaren e ka mundësu vetem kryetari me u interesu me i kry keto punë, tash me ligjin i ri ju mundëson edhe kryetarit edhe pala e interesuar munden me qenë incues të ketij ndrimi!

Z.Naim Bytyqi: a është në interes publik për banoret e fsh. Zahaq, Llabjan dhe fshatrave për rreth, nese është një pronë aty afer varrezes apo buz magjistrales me shërby për qender rinore por me ju dhënë vetem një individi, cili është interes publik? Sepse po e di që je duke e lidh me varreza.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: është dyqan që AKP-ja e ka shit me qat gjendje faktike që është ,dhe na atij pronarit i bëjm zgjidhje me legalizu atë dyqan. Pastaj nese zgjerohet dhe aty ja prek nuk besoj që zgjerohet e aty ska kurgjo ngat autostrades, aty është kalimi i shkolles. Ju e keni pa që kufar interesi tjetër ska qka me pas përveq atij banori aty!

Z.Drin Veselaj: unë të gjitha pikat po du me përmbyll në këtë pikë! Sot po ju drejtohem jo si ndonje qytetar që kërkon ndonje favor as si pale e interesuar si truall ari siq e quani ju, por si dikush që ende beson apo të paktën përpiqet të besoj, që komuna është një institucion i përbashkët dhe jo një zyrë private për këmbimin e pronave. E kemi pa me sytë tanë që si tokat publike një ndër pasurit më të çmuara të komunes tonë, përfundon në duart e ashtuquajtur investitor që ata rastësisht e dinë se kujt duhet ti trokasin në zyrë. Këmbimin e pronave publike me arsytime siq thuani ju dushkë për gogel, kjo është shëndruar në një normë, ndërkohë që qytetaret presin me pas ujë të pishem, rrugë të rregullta, çerdhe të fëmijeve etj. Komuna vepron si agjension i patundshmërive ku prona kalon dore me dore dhe publike m bet pa pronë e pa shtëpi. Me këtë plan që po ecni shumë shpejt do të na mbetet të ju themi fëmijve tonë, aty dikur ishte toka e komunes por tani janë kthyer në privilegje private gjoja për zhvillim. Kjo komunë nuk është shtëpi e juaj private, kjo është një pasuri publike që duhet të ruajtur dhe jo të jetë një pasuri që tregtohet sikur të jetë një mall në ankand. Nese e keni pas ndërmend të mbeteni në histori kryetar, ish dasht të mbetni për mbrojtjen e pronave publike e jo që këto prona publike të i ktheni në interesa private. Po ashtu ne jem i dëshmitar të këmbimit të shumë pronave në emer të interesit, siq është rasti me projektin "Borea", që janë këmbi prona për interesa të ngushta mirpo ato prona kanë mbet ashtu dhe ish dasht na me pas një përgjigje, qka është dasht me ndodh me ato pronat që janë këmbi në interes zhvillimit ekonomik të kësaj komune! Për fund meqenëse ti gjithmonë na akuzon dhe e din kush po na shkrun kto fjalime, muj me thon që për këtë fjalim autor është akademia e shkencave, ndoshta mundeni mos me kuptu, por çka do që keni mundeni me pyet sa i perket ketij fjalimit. Edhe nese je burrë thuaje emrin kush na shkrun fjalimet se që 12 vjet thush e di e di, por në fakt asniherc opozit ma të qendrushme nuk ki pas!

Z.Nezir Jahmurataj: puna për me i shërby qytetarit komuna komplet është obligim dhe duhet me i shërby. Por nuk pom pelqen këtë Florimin pom duket po e njoh aktivist i kahershem, mirpo nuk është mirë nese e ka uzurpu një pronë dhe e ka shfrytëzu 20 vjet, dhe po i jepet veq atij let është njëfar konkurence aty mrenda mos po i rritet çmimi, sespe mua më dhimbëset prona e përbashket pronar i gjithë tokave të komunes është normal kryetari së bashku me kuvend, por që 100 here kam thënë mos të jepen lirë! Ai e ka shfrytëzu që 20 vjet dhe po ja mundosojnë me bo pronë të veten duke e ndru normal por ai ka qenë duke e shfrytëzu, ktu pom doket një konkurrencë jo reale!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Nezir ty që të kam dost dubna me tu përgjigjë qajo pronë e atij Kelmendit është shit në privatizim prona, e lokalin ai e ka ble. Një pjesë e lokalit është në pronen

komunale dhe pjesa tjetër ka qenë në pronën e ndërmarjes që ja ka shit AKP-ja. Shteti nuk ka kqyr a është tokë koperative a është tokë e komunes dmth në qat objekt i ka ndërtu ato temele, Tash a mundesh me shku me ja mar atë tokë me j'a rrëzu, a ki lloagri qytetarin tënd për 17 metra me ja dëmtu me ja pre objektin, lëshoma se po më vyn me pas qetu! Qekjo është që një vlerë publike po e ndron me një vlerë në fsh.Ramun, qekjo është interesi publik që unë shumë kujdesna me ja qëllu e mos me huq Nezir.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 11 votë kunder, 1 votë e përmbajtur, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Leutrim (Florim) Kelmendi me $\frac{1}{4}$ dhe Ramë (Bajram) Muzilijaj me $\frac{3}{4}$.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat me shtëpi në pronësi të Anxha (Radosav) Ivanoviq dhe Radosav (Bogdan) Ivanoviq, me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini dhe me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini, për qëllim të Interesit Publik: Rregullimin e sipërfaqes publike buzë Lumit Lumbardh dhe shtratin e Lumit Lumbardh.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: për gjithë këta qytetarët që e din që qka bohet fjalë dhe ata që na dëgjojnë shumica e dini, janë tri shpija në urën e zallit deri tek një shtëpi afër këtyre ne kemi mbri me i shpronësu gjatë këtyre viteve ose me i bo ndrimet. Tani janë 3 shpija në emer të familjes Ajdini dhe njëra është në emer të sërbëve është e pa perkthyme dhe janë procedurat për perkthim. Mirpo janë 3 prona që janë vlersu prej ministrisë së financave, dhe janë 2 prona komunale dhe një mbi bazen siq e kemi quajt ne atherë tek ish roja e sigurisë jugosllave nelt 11 ari dhe janë 43 ari toke në mes këtyre dyqanve të tregu i gjelbert i kemi dërgu në vlersim dhe po besoj që me vlersimin e ministrisë e kryjmë edhe këtë këmbim. Mandej tek ura e zallit mbet vetem furra dhe ato dyqanet për me i largu në të ardhmen.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro, 12 votë kunder, 1 votë e përmbajtur, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat me shtëpi në pronësi të Anxha (Radosav) Ivanoviq dhe Radosav (Bogdan) Ivanoviq, me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini dhe me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini, për qëllim të Interesit Publik

6.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Kimete (Adem) Hasaj (banesë), për qëllim të Interesit Publik: " Ndërtimi i Qendrës Kryesore Familjare".

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: është një banesë private përmbi shkollën e artit të ish Kryqi i Kuq, për një parcellë që është në Zagërm. Me planin zhvillimor komunal dhe me harta zonale në të ardhmen QKMF duhet me zhvendos dhe me ndërtu në qat hapsir tek shkolla e artit.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro, 6 votë kunder, 7 (dy votë me ngritje dore) anëtar nuk marin pjesë në këmbim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me pronën e pronarit privat Kimete (Adem) Hasaj (banesë).

7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat Shkelzen (Ismajl) Gutiqi; Qehaja

Group SH.P.K; Raif (Hivzi) Kelmendi me 6/7 dhe Ali (Hivzi) Kelmendi me 1/7, për qëllim të Interesit Publik: “Rregullimi i Shtratit të Lumbardhit”.

Z.Labinot Panxha: në lidhje me këtë pikë të rendit të dites unë kam kontaktuar me disa qytetar të lagjes “Haxhi Zeka”, konkretisht Blerim Matoshi, i cili e ka dorëzuar një peticion dje. Me kërkesën që ajo pjesë që gjindet aty për këmbim të shfrytëzohet për gjelbërim ose për qka kryetari në fushatë të ndryshme ju kish premtu! Pyetja ime është mundësishtë kjo pikë e rendit të dites të shtyhet deri shqyrtimin e atij peticioni e qytetarëve, dhe kjo për faktin se i bjen me i vlersu ata qytetar që e kanë shprehur një hall të tyre. Po besoj që bashkarishtë me ata ta zgjidhni këtë far pjesë!

Z.Berat Ganiqi: është viti i tret që jam duke e përcillë si çështje, sepse me datë 26.03.2022 në orën 10:16 min unë së bashku me asambleistën Mubera Belegu, kemi pas pranuar një email për një dëgjje të shtëpisë aty afër. Dëgjja e shtëpisë dhe rethanat të asaj kohe kanë qenë teper të dyshimta, për shkak se as nuk kemi pas prova dhe as nuk kemi mujt me ngrit si çështje. Mirpo që atë kohë u përfol edhe nga banoret aty, që ajo pronë ka me u jep për ndërtim të banesave. Në hulumtimin e dokumentacionit që kemi pas kjo pronë që para luftës ka qenë pronë e PSH “Ujrat” vertetohet edhe në kopjen e planit që e posedon familja. Ndërsa në vitin 2019 në një vendim nga drejtoria e ÇPJ-së kalon në pronë komunale. Nuk e di a është zhvillu procedurë gjyqësore apo ndonje procedurë tjetër, mirpo kjo kalon në pronë komunale. Në vitin 2023 bëhet edhe më e quditshme sepse një familje tjetër ankohet, po ashtu edhe kjo familje ka zëra dhe ka dëgjuar që kjo pronë do të ipet për ndërtim të lartë. Çfarë bëhet në harta zonale nga ndërtimi ultë bëhet në ndërtim të mesëm, zona me banim U3, për rreth me zonë me banim bëhet U1. Pra nga ndërtimi i ultë kemi kalu në ndërtim të lartë. Më e dyshimit bëhet që njeri nga këmbyesit të pronave në vitin 2023, shkon blen diku afer aty për të hyrë në çështjen e këmbimit. Tjetër gjë ndodhë kur i pyet pronaret për rreth se kur do të merni këmbimin, ata përgjigjen se nuk do të marim këmbim por do të pranojmë të holla. Nuk e di që ka ardhur këtu ndonjë këmbim me të holla dhe nuk e parasheh ligji. Dy parcelat ipen më shumë për ndërtim të lartë, sepse investitori që është aty pa dasht me përmend emra është investitor që meret me ndërtim të banesave. Të dashur asambleist pa dallim partie, ne jemi betuar këtu që t’i mbrojmë interesat e qytetarit dhe jo interesat e kryetarit dhe as drejtorit dhe askujt tjetër përsonele. Për shkak se këto interesa me fakte të dokumentuara po del që nga viti 2022, e prej vitit 2019 kur ju ka ndru destinimi asaj prone është bë me një qëllim që të ipet diku tjetër në këmbim. Asnjë biznes nuk do ta akuzoj sepse bizneset operojnë aq sa ju len shteti, aq sa j’u mundësojnë institucionet. Ky lloj i këmbimit të pronës e di saksishtë qka ka ndodh dhe qka ka me ndodhë, është teper e quditshem se si lejohen e këta përsone të dëpërtojnë kështu! Në mbledhjen e KPF-së i kam thënë edhe drejtorit sepse nuk di se as kujt t’i drejtohem në ket mes, se si je shendru një përsone që po mbron interesa. Nuk e di me ke thënë që nuk je jurisit e kam të përfunduar gjuhen angleze, nuk e di a ta kanë bë qëllimshen të kanë lënë aty! Por me keto shkelje me keto prova që i kam afer ketu, është teper e quditshme si ketij përsoneit që ju ka dëgj shtëpia, drejtoria e urbanizmit së bashku me inspektionin e kam edhe procesverbalin që ma ka jep familja që ja ndalon punime dhe komuna e Pejës thotë asnjë cent nuk më ka ndihmu, janë mbledh disa qytetar dhe mi kanë bo disa dhoma sa për me jetu. Ky ka fakte që ka pagu edhe rrymë edhe ujë, dhe ka pagu tatim pronë prej viteve 80-ta e tani jemi në vitin 2025 45 vite. A jeni mar vesh me këtë familje për këmbim të pronave a keni kqyr në gjykatë a jeni të paditur? Sepse kjo familje ju ka padit dhe ktu e kam edhe kopjen e padisë dhe kam prova të bollshme për me dit ti!

Z.Arianit Krasniqi: unë nuk e kam asnjë informacion!

Z.Berat Ganiqi: ligji të obligon me i pyet gjykatat a ka ndonjë çështje kontestimore për atë pronë ligji të tregon shumë mira qka duhet me kqyr, me harta e me krejt janë ndryshu vetem me u kry ky favor në fund. Tjeter nuk kam qka me shtu por keto prova janë të mjaftushme që është bërë një shkelje shume e lartë.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: po shihet që këta janë pregatit me ndal shtetin qysh kanë bo tash e kater vite, me kërcenime i ka detyru edhe njerzit e vet në ministri me jep dorëheqje. Sepse lufta brenda tyre është bërë shumë e ashpër. Tash keta kanë mbledh prova dhe po mendojnë që e kanë shpik ujin e nxehtë. Planin zhvillimor komunal e keni të aprovuar me gjitha votat, edhe LVV ka votu komplet. Keni mbri me blloku shtetin mos me mujt ministria e financave me ardh me i bo vlersimet, keni detyru njerzit me jep dorëheqje më nuk janë në vend të punes. Më e rënda është se nuk është duke funksionuar ministria dhe ju me atë po mbureni! Na me hartë zonale qat pronen që ska pas vlere hiq e ka bo me pas vlerë, sespe komuna e Pejës duhet me ndru 20 milionë euro prona. Me i pas 20 milionë euro me i shpronësu duhet 20 vite dhe kur skam pas parc i kam bo keto ndrime dhe janë 120 ndrime që i kam bo! Sa i perket ketij rasti ekziston vendimi se qysh është bo ja kemi rrit vleren një prone që ka sherby për mbeturina. Kjo familje ka qenë uzurpatore dhe me asnjë ligj nuk mundet me fitu , të ish ardh ai me thonë që po du me hi në ndrim është ok, por nuk është lajmru asnihere. Tash u lajmru tek ju dhe ju ja boni hallin dhe e kryni kete punë. Por na sot e vndosim e votojmë që e ndrojmë këtë pronë, ata mandej meren me kto probleme për të ardhmen. Por procedurat që i zhvillojmë na janë të gjitha konform ligjit dhe nuk jemi si ju me shkel ligjin, por na e bëjmë sipas ligji dhe e bijm juve me votu se e kemi obligim. Se me pas kon ligji që ndroj Gazmend ti si kryetar komune nuk isha ardh me ju vet hiq i kisha kry krejt vet, por është një procedurë transparente të cilen një ministri që ska të bëj me ne i bën vlersimet. Ideja e ketyre është me blloku shtetin ose me i blloku komunat në të cilat nuk janë në pushtet dhe ne me u shku me u anku që spo na lojnë e po mundem. Vetem një kryetar e kanë që nuk vet hiq kta janë mundu mem bo bllokada, e unë ato bllokada i kam pre me sakicë. Kjo është mjeshtria e kryetarit që një vlerë që e ka komuna, me ja rrit vleren dhe me shti në tregu dhe me ndru. Këtë e kemi bërë dhe e kam obligim me vetqeverisje lokale, me u kujdes që vlere e komunes me u rrit dhe me punen që kemi bërë ju kemi rrit 3 fish vleren e qytetarit.

Z.Berat Ganiqi: the që janë uzurpator me 30.09.1983 i shkon atij një kërkesë për pagim borgjit të ujësjellësit nga gjykata. Ti ju ki kry uzurpatorke këmbime të pronave dhe mas luftes kta e din, nuk e kam interesin me ja këmbi pronen por qysh po doni me hek njeri pa e vet prej aty! Ti vetem përgjigjmu se qysh po i kryen keto punime vetem ktu përgjigjmu tek kto prova, qeto kundërshtoj tek te tjerat nuk jemi hy ma thellë!

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: në vitin 2019 me plan zhvillimor kemi vendos që pronave publike me ju rrit vleren. Nuk jeni të interesuar me i lexu sendet për me zhvillu këtë qytet, po qysh me blloku e unë jam këtu qysh me ja rrit vleren pasurisë komunale. Juve shetitorja buzë "Lumbardhit" po ju qmend e krejt kto punë po bëhen për të, projektin "Borea" e ndalet e mo nuk mundeni me ndal kurgjo!,

Znj.Hidajete Nikçi: unë gjatë kësaj kohe mendova se a jam në seancën e kuvendit të Kosovës a në kuvendin komunal, se a dim a po nuk dim e kuptojmë tash në tetor kur janë zgjedhjet. Për të gjithë punen kryetar që ke bo deri me tash e din qytetaret. Mirpo duhet me qen shumë i

kujdesëshem me gjuhen që përdor, sepse nuk është e hijshme me ju kthy dhe me ju thonë asambleistëve ahmak që the ma heret që ju jeni ahmaka! Duhet me pas kujdes në gjuhen e përdorur, ndërsa për çështjen e Kuvendit Komunal merret dikush tjetër.

Z.Naim Bytyqi: me sa mujta me shkru une the ne sjemi ahmaka si ju, tu kisha lut mos ofendo sepse kolega Berati i tha argumentet e veta del e kundërshtoj po mos ofendo!

Nga të gjithë anëtarët prezant me 17 votë pro,13 votë kunder (dy votë me ngritje dore),1 votë e përmbajtur, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat Shkelzen (Ismajl) Gutiqi; Qehaja Group SH.P.K; Raif (Hivzi) Kelmendi me 6/7 dhe Ali (Hivzi) Kelmendi me 1/7.

8.Shqyrtimi dhe miratimi për shfuqizimin e Vendimit Nr. 03/2025 me nr. protokolli 463/01-10508, dt. 28 Shkurt 2025 K.K. Pejë, mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negociim nga Kryetari i Komunës - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-128/3 të dt. 24.03.2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një vendim që na ka sugjerim ministria dhe na ka kthy, sespe paraprakisht është e obliguar që të krijohet marrveshje në mes të kryetarit dhe operatorit, pastaj duhet të merret vendimi në kuvend. Për këtë arsye e kemi sjellë këtë vendim për shfuqizim, pasi që kontrata me negociim është miratu prej kryetarit dhe operatorit. Tani e kemi mundësinë për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone në seancë të kuvendit.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: pra po e anulojmë vendimin paraprak dhe po e miratojmë vendimin pas sugjerimit të ministrisë për dhënien në shfrytëzim. Së pari po votojmë me anulu, pastaj vjen pika tjetër për me dhënë përfundimisht në shfrytëzim pronen për panela solare.

Nga të gjithë anëtarët prezant me 18 votë pro,2 votë kunder (dy votë me ngritje dore),11 anëtar nuk marrin pjesë në votim, miratohet shfuqizimi i Vendimit Nr. 03/2025 me nr. protokolli 463/01-10508, dt. 28 Shkurt 2025 K.K. Pejë.

9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negociim nga Kryetari i Komunës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: tash është vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të këtyre parcelave dhe është me rëndësi që aty ndërtohet një pikë të grumbullimit të energjisë. Në atë pikë e kemi një marrveshje si komunë me mujt me i kyq 2+0 he të komunes së Pejës, që në të ardhmen energjia që e shfrytëzon komuna me qenë prej burimit të ripertrishem, dhe me qenë energji që qytetaret nuk e pagujnë. Qytetaret e pagujnë njëher kur i mbarojmë ato panela solare, pastaj për 20 vitet e ardhshme për me mujt me shfrytëzu si aset i komunes.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro, 12 votë kundër (dy votë me ngritje dore), 1 anëtar nuk marin pjesë në votim, miratohet i propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi për propozim - shfuqizimin e Vendimit Nr. 76/20254 me nr. protokolli 463/01-98164, dt. 30 Dhjetor 2024, mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro, 13 anëtar nuk marin pjesë në votim miratohet shfuqizimi i Vendimit Nr. 76/20254 me nr. protokolli 463/01-98164, dt. 30 Dhjetor 2024.

11.Rishqyrtimi dhe miratimi paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin nese ka dikush diqka për diskutim, nese jo e qesim në votim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro, 4 votë kundër, 3 votë të përmbajtur, 7 (dy votë me ngritje dore) anëtar nuk marin pjesë në votim, rishqyrtimi miratohet për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025

12.Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.01-2025 (KPE) për Shërbimin e Transportit me Merimangë në territorin e Komunës së Pejës, të dt. 31.01.2025, në kërkesës së MMPHI-së nr. Nr. 04-1944, dt: 25.02.2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nese ka dikush diqka për këtë rregullore e kemi diskutu edhe në mbledhjen e KPF-së, nese jo atheter e qesim në votim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro, 13 (dy votë me ngritje dore) anëtar nuk marin pjesë në votim miratohet Rregullorja Nr.01-2025 (KPE) për Shërbimin e Transportit me Merimangë në territorin e Komunës së Pejës, të dt. 31.01.2025, në kërkesës së MMPHI-së nr. Nr. 04-1944, dt: 25.02.2025.

13.Shqyrtimi dhe miratimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Planin të Zyrës për Komunitete për 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është informatë që e kemi diskutu edhe ne KPF, nese ka dikush diqka e hapim diskutimin, nese jo kalojmë në piken tjetër.

14.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Nuk ka pasur.

15.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z.Labinot Panxha: pa dasht me lujt rolin e unifikuesit, mirepo kto debate në mes të kryetarit dhe opozites nuk po i sherbejnë aspak as demokracisë në kuvend por as interesit të përgjithshëm të qytetarit. Sidomos na Aleanca shumë here të kemi ofru mbështetje për situatat kur qytetarët kanë përfitu, asnjehere nuk mundesh me na përfsihi në një thes me askend por vetem si Aleancë. Nese na shkrujnë qytetaret po bcsoj që jemi nifar adrese e tyre, fillimisht besimin për me ardh ktu pastaj për me na kontaktu. Po të jesh i bindur që edhe prej grupit parlamentar tëndin, keta përsone që me kanë kontaktuar mua, e kanë kontaktu edhe Luanin, ma kanë përmend konkretisht që kanë bisedu edhe me Luanin, por nuk e di se sa mundet me ngrit këtë çështje. Kryetar, ta bona një pyetje se ju ki premtu hapsirë gjelbëruese aty përpara, dhe nuk mu përgjigje nuk ke korekte! Propozova me shty deri sa ta shqyrtoni peticioni nga ana e tyre, prap nuk ke korekte nga ana juaj që the kjo sot vendoset për me shku tutje. Pra i bjen nifar nënvlersimi të qytetarëve që e kanë qit nënshkrimin aty, janë të lagjes tënde dhe ju i njihni ata me mire se sa unë, dhe e dini situaten më mirë. A ju ki premtu a nuk ju ki premtu park te ajo hapsirë ku po bëhet fjalë? Janë edhe disa pjese e probleme tjera nëpër fshatra sepse ka mungesë sidomos në Lugun e Baranit, mungesë ndriqimit publik, kanalizimeve, trotuareve e shumë çka tjeter. Sepse me permend ujësjellësin u bo bozë ajo far pune per ty ,se na e kem hall e jetojmë me atë problem tash e sa vite.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: kërkoj falje Labinot që nuk tu kam përgjigjë, qata qytetarë që kanë ardh te ti, sot janë ardh edhe tek unë dhe ajo pjesa që ju kam premtu mbetet gjelbërim.Ndërsa sa i perket çështjeve tjera sa te kemi buxhelit qaq edhe mundemi me kry punë.

Z.Feriz Gashi: e kam një pyetje për drejtorin e sherbimeve publike, por ndoshta mundet mem ndihmu edhe kryetari. Mos do të ishte më mirë me bo një rreth rrotullim tek rruga që të dërgon te spitali dhe tek qendra e qytetit, qoftë edhe i improvizum. Ata që udhëtojnë çdo dite tek spitali e din se sa janë të gjata pritjet për me u kyq në rrugen kryesore. Unë, nuk jam ekspert i kësaj pune ndoshta nuk është zgjidhja më e mire, por kishte me qenë mire me provu nihere rreth rrotulli të improvizuar.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Feriz, edhe na jemi të atij mendimi me bo rrethin, brenda javes ish dasht me fillu punimet por se di pse operatori e ka shty këtë punë. I kemi pas 3 eksperta që janë mar me këtë punë, edhe nuk është zgjidhje mirepo mbasi po dojmë me eksperimentu ta shohim qysh po del ajo punë aty!

Z.Drin Veselaj: para se me i bo pyetjet për ekzekutivin u nxita kur kryetari i thotë Naimit po shpif në ata që tha se une nuk jam hajvan si ju, na si zakonishtë gjithmonë me dëshmi i qesim që kryetari e tha qashtu(lëshon video incizimin në telefon). Kjo nuk është aspak në gjuhen parlamentare qekjo formë qysh ti sillesh, sepse mos mendo që ktu e ngrit zërin dhe e tut dikend këtu! Pyetja ime është për drejtorine arsimit pasi që edhe unë jam pjesë e bordit të shkolles "Lidhja Prizerenit", zakonishtë na marim vendime për me mbledh mjete për renovim të shkolles. Heren e fundit ke shqetësim për një dritare që e ka fry era dhe është rrëzu u deklarë që është bë

kërkesa në DKA, mirpo nuk kanë marr përgjigje. Kisha pas deshir me pyet a është bërë kërkesa dhe pse nuk reaguat shpejt pasi që ajo është një rrëzik për nxënësit e asaj shkolle. Gjithashtu një shqetësim tash e sa ditë për gjithë qytetaret është rruga te fakullteti i Biznesit që është shëndëruar nga tri korsi është bërë në dy korsi. A mendoni se duhet me kthyer prapë qysh ka qenë, apo keni ndonjë zgjedhje që është më afatgjatë? Jo që ajo mundësia më e mirë për me u heq ato pritje, por mendoj që ka qenë më e favorshme se tash!

Z.Nezir Jahmurataj: pyetje për kryetarin dhe drejtorin e shërbimeve publike. A do të asfaltohen do rrugica në fsh Lubeniq? A po punohet në drejtim të kanalizimit të ujërave të zeza në Lybeniq? Çështja tjetër është tek rruga e fakulltetit që e përmenden koleget e cila ka shumë vretje dhe tek furra Ahmeti dalja për Loxhë është një tollovi e madhe. Kishte me qenë mirë me provu diqka sepse ka ngecje të mëdha në komunikacion. Po ashtu rruga në Baran është një rreth i rrezikshëm për qytetaret dhe mjeteve motorike.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Nezir, për rrethin që po e kërkon për Baran dhe Raushiq ministria e ka përfunduar projektin tash nuk e di kur e aprovon dhe kur e qet në procedurë. Kanalizimin e kemi problem kemi ardhur prej impiantit të pastrimit të ujërave të zeza dhe po e hekim në Loxhë në bin që e kemi qit kanalizimin sepse është bërë një gabim i rëndë, jemi duke e përmisur. Sepse e kemi një problem me një pronar privat në Loxhë për me vazhdu me tutje me ardhur deri në Raushiq. Mandej kur kryhet pjesa në Raushiq na mbetem me lidh sespe e di problemin në Lybeniq që ju vjen kanalizimi në kanalën e hapur, por ajo mbetet për vitin tjetër me punu. Ndërsa sa i përket rruges tek fakullteti ne jemi konsultu me ekspertin dhe tash jemi duke e qel rrugën që ata qytetar që i qojnë fëmijet në qerdhe janë diku 300 familjar. Jemi duke e qel rrugën për me dal prej qerdhes me dal në pjesën e bistrices përfundim mahalles Protes. besoj gjatë që gjatë verës ose për dy muaj e kryjmë qat rrugë në varet prej operatorëve si punojnë, por deri në fund të verës këto probleme kanë me u zgjidhë.

Znj.Leonora Bala: lidhur me nenin 57 Procedurat e prokurimit për shërbime të veqanta, konkretisht drejtorit të drejtoratit për shëndetësi. Sipas këtij neni lejohen procedura të veqanta, shërbime të veqanta. Ndërsa neni 57.3 thotë: Shërbimet e veqanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbimet profesionale të cilat autoriteti kontraktues ka nevojë dhe por cilat shërbime nuk mundet t'i kryej vet. Në këtë rast kush janë kontraktoret individual sepse neni 57.1 e definojnë këtë? Cilat janë këto shërbime të veqanta të cilat janë duke i krye dy mjekë familjar, që janë punësuar pasi që kanë dalë në pension? Me çfarë procedure janë punësuar ata, kur e dim që ligji te na nuk e lejon punën pas pensionimi? E kemi diskutuar këtë çështje edhe në komitet për shëndetësi por për fat të keq nuk ke qenë prezent dhe po ashtu është vlersu që është njëfarë keqpërdorimi. Ndërsa pyetja tjetër në shërbimin primar në QKMF janë punësuar familjarët e drejtoreshes znj.Myrvete Salhi, konkretisht dy vajzat e saj. Me cilën procedurë ligjore këto janë pranuar në punë?

Z.Rajan Arapi: e kisha ngrit një çështje edhe pse jam i vetdijshëm që kjo më shumë i takon nivelit qendror. Bëhet fjalë për rrugën Pejë- Rugovë, e cila është në gjendje jo të mirë, qoftë në aspektin e gropave, qoftë në aspektin e mirëmbajtjes. Edhe pse ministria e ka kompetencë prapë qendrojnë prapa asaj se qytetaret e këtij vendi Rugova i takon pjesë tonë dhe çdo ditë rrezikohen kur kalojnë, shkojnë në ato zona dhe në ato fshatra turistik. Çfarë po ndërmerrni për ta nxitur për ta pasur mirëmbajtjen sa më të mirë, për ta rregulluar këtë rrugë? A jeni në kontakt me

ministrinë? Sepse prap po them qytetaret po rezikohen, veturat po dëmtohen, pothuajse çdo ditë gjatë kalimit në atë rrugë.

Z.Berat Ganiqi: Çështja e parë ka të bëjë me qendren e qytetit, ju e keni këtë kshillin KKSBB mundeni me ngrit si çështje dhe me kërkim nga policia të ketë ma shumë patrullë. Kishte me qenë të ngritni si çështje dhe policia të fokusohet që të ketë më shumë policë prezent në shesh, për shkak se tash po ka policë shumë të ri dhe munden me mbulu këtë pjesen tjetër. Çështja e dytë është t'i kërkoj drejtorisë DKRS-së, që përfituesit të subvencioneve secili asambleist në emër LVV po e bëjë kërkesë zyrtare, që brenda afatit optimal të na dërgoj secila OJQ sa është pagu dhe sa ka fitu prej atyre subvencioneve, pa dasht me paragjyku qka, qysh tek mirpo kjo është kërkesë e imja. Ndërsa për rrugën e Rugovës që e ngriti z.Rajani, mirë është sa e di tash fillon stanimi emergjent kontrata veq është nënshkru ankesa nuk ka me pas pasi që është nënshkrim përfundimtar. Por kjo e lshitjes së gurëve është një operator tjetër dhe ky operator është vllau ose djali i axhës këshilltarit të kryetarit që e ka mirëmbajtjen e rruges, vetem kanë pas me hi në zyrë dhe me thonë ndreqini. Çështja e fundit gjuhen e debateve që po e dëgjoj këtu është për keqardhje, këto fjalë këtu nuk kanë vend. Megjithatë është kultura e gjethekujtë e me të vendos tyllfar etiketa kultura e juaj vazhdoni, në kulturen time nuk është me ta kthyer sepse je kryetar i qytetarëve nuk ta kthejë njëjt!

Kryetar Gazmend Muhaxheri: rruga e Rugovës është problem që 7 vite e ju jeni në pushtet që 5 vite! Por ju që 5 vite në mirëmbajtjen e rruges kurgjo nuk keni investu. Operatori ekonomik që është vllau i një zyrtarit tonë, e ka mirëmbajtjen e rrugëve tjera e jo rruges së Rugovës që jeni ju të obliguar me vendos! Ju ja keni jep një operator të Podujevës dhe nuk j'ua keni jep atij që e ka mirëmbajt gjithmonë. Për me qit tenderin për riparimin e dëmeve, komuna e Pejës është dasht me bo projektin dhe me dorëzuar në ministri për me tenderu. As projekt nuk keni nuk keni mujt me bo si ministri, aq e keni degraduar atë ministri sa që nuk keni mujt me bo as projekt. Që 5 vjet nuk keni mujt me qit tender me rregullu at rrugë, por keni qit tender për hartimin e projektit qysh kanë me rehabilitu këtë rrugë. Projekt 350 mijë euro me bo projektin e rehabilitimit të rruges Pejë-Kuqishtë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një çështje që kisha dasht me ngritë është puna e hekurudhës dhe lëvizjes së trenit brenda territorit të komunës së Pejës dhe në zona tjera. Vit pas viti po shkaktohen sikuata teper të vështira me viktimë dhe po pësojnë qytetarët e komunës tonë. Lëvizja e këtij treni nëqoftëse nuk mundet me i plotësu kushtet standarde për lëvizje përmbi hekurudhë, kishte me qenë mirë me u ndal komplet nese vazhdon me pësu qytetarët dhe me pas vdekje. Edhe pse thuajse në çdo vend ku kalojnë veturat për mbi shina, shihet që agjensioni i hekurudhave a po kush e ka në kompetencë standartin e sigurisë nuk e ka aspak! Mendoj që shkak i viktimitave që po ndodhë vit për vit është shkak i mos mirëmbajtjes së tyre në vendkalimin ku kalojnë veturat. Kjo temë mendoj që duhet të shtjellohet nga senacat komunale me ministrinë e Linjes, sespe çështja është teper serioze.

Z.Naim Bytyqi: pajtohem plotësisht në këtë çështje me juve dhe ne qka mundemi me bo dhe me ndiku jemi me ty, sepse me të vërtet treni Fushë Kosovë- Pejë më teper është duke bërë dëm se dobi. Ne nuk mundemi me ndal, por mundemi me ngrit si çështje me u zgjidh problemi që këto aksidente mos me ndodhë.

Znj.Xhenete Syka Kelmendi: deshta edhe njëhere të theksoj kontributin e secilit prej jush në ngritjen e transparences. Të gjitha procedurat në ndarjen e subvencioneve dhe asociacionet për rini dhe sport janë nda sipas rregullave dhe normave tek drejtoria e DKRS-së. Duke filluar nga thirrja publike, vlersimi i aplikacioneve, përbërja e komisioneve dhe çdo vendim është valid dhe publik. Ju kujtoj edhe njëhere sa i perket dhënjes së informatave shitesë ne do të bazohemi tek neni 12 Ligji për qasjen e dokumentave zyrtare, gjithësesi të kemi parasysh ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Secili nga ju që jeni të interesuar në ndonjë informacion shitesë mund të qaseni edhe përmes postes elektronike, dhe brenda afateve ligjore do ti keni të kompletuar pyetjet tuaja.

Z.Bujar Agusholli: një pyetje për kryetarin se a e ka në plan ndonjë binajkëzim me ndonjë shtet në Indi sepse lopët në qytetin tonë shetit, nese e keni në plan e kisha miratu! Ndërsa për drejtorin e shërbimeve publike a ka ndonjë shenje të komunikacionit që mundën mi vendos , puna e atyre lopëve që e terrorizojnë krejt qytetin, a mundeni diqka me bo? Çështja tjetër është për rrugën në Jarinë që ka qenë plan me fillu nga muaji janar, është koha e duhur nese e keni në plan.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: është punë që inspektorati komunes nuk ka mujt me zgjidh punë as me denime, dhe as me ja mbledh atij lopët. problem qysh mundet me u zgjidhë kjo punë kur nuk ka mekanizma. Ndërsa për rrugën në Jarinës jemi duke e prit "Hidro Drinin" me ndru gypin. Kemi bisedu me drejtorin dhe janë të interesuar me ndru gypin në rrugën kryesore, nese e kryjnë para vjeshtes kemi mundësi nese jo athere e lejm për vitin tjetër.

Z.Berat Ganiqi: problemi tek rruga e Rugoves është që kryetari po don me personaliziu, me kthy në përfitim për shkak të votave komunale. Aty ka qenë një kompani dhe nuk i kam faj kompanisë që ka vjedh, e ka vjedh fondin por është me aktakuzë në gjykatë duke u përballur me procedurë gjyqësore. Për dallim prej tjerëve qat korupcion na e kemi qit, kemi thonë spo punon kompania dhe e kemi qit në prokurori dhe ishalla e mer denimin e merituar. Asnjëhere nuk jam mar me rrugë rasti i parë ka qenë dhe ka përfundu me aktakuzë sepse e kemi me pa me sytë e tonë qka ka bo, e kemi mbrojt interesin e qytetarëve të Pejës.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 12:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=5EMeASIGgkc>

Procesmbajtësja,

znj. Donjeta Morina



KRYESUESI I KUVENDI,
z. Rexhep Kurtbogaj



